

***Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla, Dekret Nr. 586 dt. 17.3.1948, G. Z. Nr. 39/1948, aprovuar me Ligjën Nr. 609 dt. 24.5.1948, G. Z. Nr. 72/1948.***

#### Neni 1

Të gjitha monumentet e lujtëshme dhe të pa lujtëshme kulturale dhe historike. artistike dhe ethnografike, sidhe sendet natyrale të rralla me karakter botanik, gjeologjik. paleontologjik. minerallogjik, petro- grafik dhe gjeografik, ose me bukuri të veçantë, vihen nën mbrojtje të Shtetit pa marrë parasysh se kush i ka në pronësi ose në posedim.

Vlefta shkencore dhe estetike e këtyre sendeve është pasuri e përbashkët e popullit.

#### Neni 2

Që të ruhen monumentet e kulturës dhe sendet natyrale të rralla, Qeverija ngarkon një organ të veçantë për studimin shkencor dhe mbrojtjen e këtyre monumenteve.

#### Neni 3

Objektet që sipas nenit 1 të këtij dekreti vihen nën mbrojtjen e Shtetit caktohen me vendim të organit të posaçëm. Kur objektet janë sende të palujtëshme në vendim caktohen dhe kufit' e tyre si dhe të rretheve të tyre që u shtrohen kufizimeve të parashikuara prej këtij dekreti.

Kundër vendimit të organit bëhet ankim në Kryeministri që vendos në shkallë të dytë dhe të fundit.

Kur nuk dihet mirë nëse një send është nga ato që sipas nenit 1 të këtij dekreti vihen nën mbrojtjen, efektet e mbrojtjes fillojnë që nga dita që pronari ose poseduesi ose përfaqësuesi i t.ij ligjor lajmërohet nga ana e organit se sendi konsiderohet i mbrojtur.

Vendimi i shkallës së fundit që deklaron të mbrojtur një send të palujtëshëm traskriptohet në zyrën e ipotekave.

#### Neni 4

Monumentet e luejtëshme dhe të palujtëshme që sipas nenit 1 të këtij dekreti janë vënë nën mbrojtje nuk mund të gërmohen. të trans- kriptohen. të ndreqen. të restaurohen. të vihen në mure ose të shkatërrohen pa autorizimin e organit.

Gjithashtu brenda kufive të caktuar për sendet e palujtëshme sipas nenit. 3 paragrafi I të këtij dekreti. ndalohet çdo ndërtim dhe çdo ndry- shim i terrenit pa autorizim të organit.

#### Neni 5

Monumentet e lujtëshme të vëna nën mbrojtje nuk mund të jetër- sohen, të lihen peng ose të transllokohen në një vend tjetër pa u lajmëruar më parë organi i cili mund të ndalojë çdo translokim kur ky është në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes.

Gjithashtu monumentet e sipërme nuk mund të nxiren jashtë Shte- tit veçse për arsye të justifikuara dhe me autorizim të organit.

#### Neni 6

Të gjitha sendet e lujtëshme dhe të paluejtëshme që përmenden në nenin 1 të këtij dekreti me qëllim që të mbrohen më mirë dhe të studjohen shkencërisht, mund të çpronësohen në bazë të dispozitave li- gjore që janë në fuqi me çpronësimet për interes të përgjithëshëm.

#### Neni 7

Për nevoja shkencore, organi mund të bëjë studime shkencore, gër- mime dhe eksperimente në sendet e lujtëshme dhe të palujtëshme të Shte- tit dhe të personave privatë, nga ato që përmenden në nenin 1 të këtij de- kreti dhe për të cilat nuk është vendosur akoma sipas nenit 3 nëse do të vihen nën mbrojtje.

**Këtë të drejtë organi mund t'u a japë edhe institucioneve të tjera shkencore ose punonjësve të shkëncës.**

Për dëmet që shkaktohen në sendin e palujtëshëm nga gërmimet dhe eksperimentet e sipërme në qoftë se sendi nuk shpronësohet. pro- narit do t'i paguhet shpenzimi përkatës në bazë të dispozitave në fuqi mbi çpronësimin për interes të përgjithëshëm.

## Neni 8

Pronari ose personat e tjerë fizikë ose juridikë. që. duke vepiuar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi i parë të këtij dekreti, shkaktojnë ndonjë dëm në monumentin e mbrojtur, detyrohen që me shpenzimet e tyre dhe sipas udhëzimeve të organit t'a kthejnë sendin në gjendjen e mëparëshme ose të paguajnë dëmshpërblimet.

Në rast se personat e sipërmë e përsëritin shkeljen e nenit 4, ose dëmtojnë me qëllim monumentin e mbrojtur. ose këtë e translokojnë pa leje në një vënd tjetër, ose tentojnë t'a nxjerrin jashtë Shtetit, atëhere ky send, me vendim gjyqi, i merret pa asnjë shpërblim.

Personat që shkelin nenin 4 paragraf i dytë të këtij dekreti, detyrohen që, me shpenzimet e tyre dhe sipas udhëzimeve të organit kompetent për mbrojtje. të rëzojnë objektet e ngritura dhe t'a kthejnë terrenin në gjendjen e mëparëshme ose të paguajnë dëmshpërblim.

Vendimi për marrjen e sendit nga pronari pa shpërblim sipas paragrafit 1 e 3 të këtij neni, jepet nga gjykata mbi kërkimin e organit kompetent për mbrojtjen.

Kundër vendimit palët kanë të drejtë ankimi në gjykatën më të lartë.

## Neni 9

Organi kompetent për mbrojtje. është i autorizuar që, me shpenzimet e Shtetit, të bëjë të gjitha punimet që janë të nevojëshme për mirëmbajtjen e monumentit të mbrojtur.

## Neni 10

Kur pronari i sendit të lujtëshëm ose të pa lujtëshëm nga ato që përmenden në nenin 1 të këtij dekreti, do t'a shesë sendin, është i detyruar që t'a ofrojë më parë për blerje në organin kompetent për mbrojtje ose në një institut tjetër të treguar prej tij dhe këto, brënda 30 ditëve, duhet të përgjigjen në se do të përdorin të drejtën e blerjes.

## Neni 11

Të gjitha sendet e lujtëshme kulture dhe historike, artistike, dhe etnografike, sidhe sendet natyrale të rralla, që pas hyrjes në fuqi të këtij dekreti zbulohen, çkëputen me çdo mënyrë nga toka, nxirren nga uji ose gjënden me rastin e gërmimeve dhe kërkimeve shkencore që bëhen për

llogari të Shtetit ose me autorizimin e organit, bëhen të gjitha pa- suri shtetërore.

Të gjitha sendet e gjetura duhet të sigurohen me shpenzimet e institutit ose të personit privat që bëri gërmimet.

#### Neni 12

Ndalohet, pa autorizimin e organit kompetent për mbrojtje, marrja e fotografive ose filmave teknike, matja dhe vizatimi i monumenteve të mbrojtura të luejtëshme dhe të paluejtëshme.

*(Ndryshuar me Ligjën Nr. 609 dt. 24.5.1948)*

#### Neni 13

Kushdo që shkel dispozitat e këtij dekreti dënohet. sipas rastit, në bazë të nenit 269 ose 270 të Kodit penal.

*(Ndryshuar me Kodin penal)*

#### Neni 14

Autorizohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë dispozita për zbatimin e këtij dekreti.

#### Neni 15

Ky dekret hyn në fuqi nga data e botimit të tij në Gazetën zyrtare.

*Mbi masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 130 dt. 9.4.1955 G. Z. Nr. 5/1955.*

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë. duke marrë parasysh se udhëheqja dhe kontrolli për mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve historike, arkeologjike, t'arkitekturës dhe t'artit nuk realizohet në mënyrë të kënaqëshme, dhe me qëllim që të sigurohet në t'arthmen një mbrojtje më e mirë e tyre, në bazë të nenit 14 të ligjës Nr. 609 datë datë 24.5.1948 «Mbi mbrojtjen e monumenteve të kuiturës dhe të sendeve natyrale të rralla», vendosi'

1. Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës, ruajtjen, restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të kulturës të kryhet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

2. Ruajtja e monumenteve të kulturës që ndodhen në vendet e ndryshme të Republikës, të bëhet nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve, rretheve, qyteteve, lokaliteteve dhe këshillavë popullore të fshatrave përkatëse.

3- Universiteti Shtetëror i Tiranës:

a) të krijojë pranë muzeut arkeologjik-etnografik një atelie e cila të merret me mirëmbajtjen, ruajtjen, dhe restaurimin e monumenteve të kulturës dhe të parashikojë në buxhetin e tij vjetor fonde e materiale të nevojshme që do të përdoren për këtë qëllim për monumentet e kulturës që nuk janë dhënë me qira për shfrytëzimin ekonomik;

b) të formojë një këshillë metodike-shkencor për mbrojtjen e monumenteve të kulturës me përfaqësues të tij, të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, të ndërmarrjes «Projekti» dhe specialistë të ndryshëm në lëmin e studimit dhe të restaurimit të monumenteve të kulturës duke i ngarkuar këtij këshilli udhëheqjen e punës metodike-shkencore në ruajtjen dhe në studimin e monumenteve të kulturës, në perfeksionimin e metodave shkencore të punimeve të restaurimit dhe në caktimin e klasifikimit shkencor të monumenteve të kulturës;

c) të përpunojë dhe të aprovojë rregulloren e këshillit metodiko-shkencor të sipërmë;

ç) të përfundojë, brenda vitit 1958, regjistrimin e të gjitha monumenteve të njohura gjer më sot dhe që duhet të figurojnë në listat shtetërore të monumenteve të kulturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Mbi ruajtjen e monuvientave të kulturës, Rregullore e aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 130 dt. 9.4.1955, G. Z. Nr. 5/1955.*

### *I. Dispozita të përgjithëshme*

1. Të gjitha monumentet e kulturës, që ndodhen në tokën e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe që kanë një rëndësi

shkencore, historike ose artistike janë pasuri e paprekshme e gjithë popullit dhe vihen nën mbrojtjen e Shtetit. **1169**

2. Monumentet e kulturës i nënshtrohen mbrojtjes së Shtetit ianë:

a) monumentet e arkitekturës: ndërtesat civile dhe fetare, kala e kulla. gërmadha e mbeturina të ndërtesave arkitekturale. ura, monumente varesh të vjetra, mauzole. etj., ashtu edhe gjithë veprat e pikturës e skulpturës monumentale. artit të aplikuar dhe të artit të kopshtijeve e parqeve që lidhen me 'to;

b) monumentet e artit: veprat e pikturës dhe të skulpturës së Kavaletit, veprat e grafikës dhe objektet e arteve dekorative. që ndodhen nëpër institucione dhe vendet e ruajtjes shtetërore. ashtu edhe monumentet e skulpturës;

c) monumentet e arkeologjisë: ndërtimet lakustre (ndër brigjet e liqejeve), vënde dhe shpella ku gjënden eshtra kafshësh paleontologjike, tumulat, qytezat e gradishtet, mbeturinat e stacioneve. banimeve dhe qyteteve të lashta, mburoja toke, llogore. gjurma të kanaleve të ujitjes dhe rrugëve, nekropole, pikturat, skulptimet dhe mbishkrimet e lashta. ashtu dhe objekte antike të ndryshme;

ç) monumentet historike: ndërtesat dhe vëndet që lidhen me ngjarje të rëndësishme të historisë së popullit tonë, me lëvizjen revolucionare dhe me Luftën Nacional-Çlirimtare të tij, me ndërtimin e socializmit, monumente që kanë një rëndësi përkujtimore të lidhura me jetën dhe veprimtarinë e personaiiteteve të shquara shtetërore dhe politike, me herojt e popullit dhe me njerzit e teknikës, të artit ushtarak, të ekonomisë dhe jetesës.

3. Monumentet e kulturës që, simbas nenit 2, vihen në mbrojtjen e Shtetit, përmbahen në lista të posaçme që aprovohen nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

4. Monumentet e kulturës, që kanë një rëndësi të madhe shkencore historike dhe artistike përshkruhen në një listë të veçantë dhe mbi propozimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës. shpallen nga Këshilli i Ministrave si monumente kombëtare.

5. Monumentet e kulturës me karakter kompleks, që kanë një rëndësi të veçantë shkencore historike ose artistike, mund të shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave monumente të një mbrojtjeje të veçantë.

6. Monumentet e kulturës, të mbledhura nëpër muze dhe nëpër vënde të tjera të ruajtjes, duhet të regjistrohen dhe të ruhen sipas dispozitave të caktuara për muzetë dhe për vëndet e tjera të ruajtjes. sikurse është

vendosur nga ana e organeve shtetërore qendrore nën drejtimin e të cilave ato ndodhen.

7. Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës, ruajtjen, restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të kulturës, bëhet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

8. Ruajtja e monumenteve të kulturës u ngarkohet komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve, rretheve, qyteteve, lokaliteteve dhe këshillave popullore të fshatrave.

9. Ndryshimi, (modifikimi), lëvizja nga vëndi dhe çdo farë punimi në teritorin e monumenteve të kulturës dhe në -«monumentet të një mbrojtjeje të veçantë», ndalohet dhe mund të bëhet vetëm me një autorizim të posaçëm nga:

a) Këshilli i Ministrave, për monumentet kombëtare dhe për monumentet e një mbrojtjeje të veçantë»;

b) Universiteti Shtetëror i Tiranës për monumentet e tjera.

10. Fondet që merr Universiteti Shtetëror i Tiranës për monumentet e kulturës duhet të shpenzohen vetëm për nevojat që kanë të bëjnë me mbrojtjen, riparimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës.

11. Kur, për raste të jashtëzakonshme, jepet autorizim për modifikimin ose translokimin e monumentit të kulturës, Universiteti Shtetëror i Tiranës duhet të organizojë kryerjen e punimeve shkencore të monumenteve në fjalë (gërmimet, fotografimet, matjet, hartimin e skicave e vizatimeve, dorëzimin e disa sendeve të gjetura muzeve, etj.). Punimet e rivendosjes, shpenzimet që bëhen me këtë rast, rëndojnë mbi vetë atë institucion që ka marrë autorizimin e translokimit ose të modifikimit të këtyre monumenteve.

## **II. Mbrojtja e monumenteve t'arkitekturës**

12. Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës, ruajtjen, restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të arkitekturës, bëhet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

13. Të gjitha monumentet e arkitekturës në lidhje me përdorimin e tyre ndahen në tre grupe:

a) monumentet e arkitekturës që nuk mund të përdoren për qëllime praktike (mure të vjetra, godina të rrënuara, çesme, monumente skulpturale etj.);

b) monumente që mund të përdoren, por ekskluzivisht nga institute shkencore dhe muze, duke ruajtur fizionominë e tyre artistike dhe historike, mobilimin e brendshëm dhe gjendjen e jashtëme (muze, fortesa muze kisha e xhami, muze manastire, etj.);

c) monumente që mund të përdoren për shfrytëzim, po pa pësuar ndonjë dëm përsa i përket ruajtjes së tyre, pa cënime të vlerave historike e artistike, kur këto u jepen organizatave, institucioneve dhe personave të ndryshëm.

14. Përdorimi i monumenteve të kulturës të shënuara në gërmat «b» dhe të pikës 13 lejohet vetëm në bazë të kushteve të caktuara nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, të përmbajtura në kontrata të posaçme.

15. Ndërmarrjet, institucionet shtetërore, organizatat dhe personat që kanë me qira monumente të arkitekturës, që përfshihen në listën e monumenteve të kulturës, i mbajnë dhe i përdorin këto simbas kushteve të parashikuara nga kontrata përkatëse që lidhet nga drejtuesit e institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve, organizatave dhe personave me përfaqësuesit e Universitetit Shtetëror të Tiranës.

16. Drejtuesit e ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore, të organizatave dhe personat që përdorin monumentet e arkitekturës janë përgjegjës për ruajtjen dhe riparimet e nevojshme sipas udhëzimeve të Universitetit Shtetëror të Tiranës për mirëmbajtjen e pjesëve ku ndodhen monumentet dhe për organizimin e ruajtjes përkatëse të këtyre monumenteve.

17. Ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe personave qira--marrës që nuk respektojnë kushtet e kontratës, duke rrezikuar në këtë mënyrë dëmtimin e monumentit të marrë me qira, me kërkesë të Universitetit Shtetëror të Tiranës u hiqet menjherë e drejta e përdorimit duke u detyruar njëkohësisht që të paguajnë të gjitha dëmet që i janë shkaktuar monumentit.

18. Punimet e restaurimit dhe të riparimit, ashtu edhe punimet e studimeve shkencore që lidhen me sondazhet e monumenteve të arkitekturës ose punimi i tokës dhe gërmimet brënda kufijve të zonës së ruajtur mund të bëhen vetëm në bazë të autorizimit të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

19. Universiteti Shtetëror i Tiranës cakton rreth monumenteve të arkitekturës zona ruajtjeje sipas madhësisë dhe rëndësisë së tyre.



20. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, qyteteve dhe këshillave popullore të fshatrave në territorin e të cilave ndo- dhen monumente të arkitekturës, kanë për detyrë:

a) të kujdesen për mbajtjen në gjëndje të mirë dhe për ruajtjen e monumenteve të arkitekturës që janë në përdorim të ndërmarrjeve, institucioneve të ndryshme shtetërore, organizatave ose personave në bazë të kontratës të nënshkruar prej tyre;

b) të vënë në dijeni Universitetin Shtetëror të Tiranës për marrjen e masave të duhura dhe mbajtjen në gjëndje të mirë (riparim dhe restaurim) të monumenteve të arkitekturës, të cilat nuk përdoren nga ana e ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore, organizatave dhe personave të ndryshëm.

### III. *Mbrojtja e monumenteve të artit*

21. Kontrolli për mbajtjen në gjëndje të mirë, për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve të pikturës dhe të skulpturës, të grafikës dhe të artit dekorativ, ushtrohet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës pavarësisht nga cili institucion, ndërmarrje ose organizatë varen këto ashtu edhe nga vendi ku ndodhen (nëpër ndërtesa ose të hapura).

22. Konservimi dhe restaurimi i monumenteve t'artit, pavarësisht nga cili institucion, ndërmarrje ose organizatë varen, mund të bëhet vetëm me autorizimin e Institutit të Shkencave.

23. Universiteti Shtetëror i Tiranës ka të drejtë të kontrollojë shit- blerjen e sendeve të ndryshme historike, arkeologjike dhe artistike dhe gëzon të drejtën e precedencës në blerjen e këtyre sendeve, edhe kur këto janë blerë nga institucione ose persona të tjerë pa dijeninë e tij.

### IV. *Mbrojtja e monumenteve arkeologjike*

24. Kërkimet dhe gërmimet arkeologjike bëhen vetëm me autorizimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës.

25. Institucionet dhe organizatat të Cilave u jepet autorizimi për të bërë kërkime ose gërmime arkeologjike të ndonjë monumenti, detyrohen, që nga fillimi gjer në mbarim të punimeve, të marrin masat e duhura për ruajtjen e monumentit nga rrënimi ose nga vjedhja.

26. Komitetet ekzekutive kanë për detyrë:

a) të kujdesen që kërkimet ose gërmimet arkeologjike të bëhen vetëm nga personat që kanë të drejtë të bëjnë këtë gjë në bazë të autorizimit të lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës;

b) të mos lejojnë që monumentet arkeologjike (si p.sh. mbeturinat e qyteteve të lashta, rrënimet dhe gërmadhat e qyteteve të vjetëra, të tumulave, të vorezave, etj. të përdoren si material ndërtimi, për kullotje, lëvrim ose për çfardo qëllim tjetër;

c) të ndalojnë menjëherë të gjitha gërmimet dhe veprimet e tjera arbitrare që mund të shkaktojnë rrënimin e monumenteve arkeologjike.

27. Universiteti Shtetëror i Tiranës cakton rreth monumenteve arkeologjike zona ruajtjeje sipas madhësisë dhe rëndësisë së tyre.

28. Zbulimet e ndryshme arkeologjike që bëhen rastësisht në vazhdim të punimeve bujqësore, të bonifikimeve, të çeljeve të kanaleve, të ndërtimeve dhe punimeve të mëdha shtetërore (si miniera, hidrocentrale) dhe çelje rrugësh duhet t'i njoftohen menjëherë Universitetit Shtetëror të Tiranës, i cili është i detyruar të dërgojë në vënd brënda një afati prej 7 ditësh përfaqësuesin e vet për studimin e vëndit të zbulimit dhe marrjen në dorëzim të materialit të gjetur.

Në rast se monumenti i zbuluar nuk është i luejtëshëm dhe vlefëta e tij arkeologjike është e madhe, punimet e filluara duhet të pësojnë në këtë vënd një ndryshim të tillë që të lejojë ruajtjen e monumentit.

29. Monedhat e gjetura gjer tani dhe që do të gjënden nëpër thesarët e ndryshme duhet t'i dorëzohen Universitetit Shtetëror të Tiranës, i cili duhet të sigurojë ruajtjen, përshkrimin shkencor dhe shpërndarjen e ekzemplarëve të tyre për ekspozim nëpër muze.

#### *V. Mbrojtja e monumenteve historike*

30. Regjistrimi, mirëmbajtja, restaurimi dhe përdorimi i monumenteve historike bëhet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

31. Për të gjitha çështjet që i përkasin ruajtjes, mbajtjes në gjëndje të mirë dhe përdorimit të monumenteve historike, zbatohen, sipas rasteve, pikat 13 gjer në 20 të kësaj Rregulloreje.

#### *VI. Mbrojtja e pasurisë së muzeve*

32. Muzetë shtetërore janë vendet kryesore të ruajtjes së koleksioneve të monumenteve të luejtëshme të kulturës.

Muzetë shtetërore ndahen në:

- a) muze qendrore;
- b) muze lokale.

33. Përgjegjësia e ruajtjes së koleksioneve që ndodhen të mbledhura në muze u ngarkohet organpve që kanë muzet nën drsjtimin e tyre direkt.

34. Çdo nxerrje jashtë nga muzetë e koleksioneve artistike dhe arkeologjike ose e koleksioneve shkencore ashtu edhe e objekteve të veçanta të marra prej këtyre koleksioneve, ndalohet. Dhënia e tyre institucioneve të ndryshme shtetërore ose organizatave mund të bëhet në bazë të një autorizimi të posaçëm për çdo rast të veçantë nga ana e organeve qendrore kompetente nga i cili varet muzeu.

35. Universiteti Shtetëror i Tiranës mund të marrë nga muzetë lokale objekte të cilat janë të nevojshme për qëllime studimi ose arësyje të tjera shkencore dhe t'i bjerë në muzetë e tij qendrore me afat të përkohëshëm ose përgjithmonë.

36. Transferimi i muzeve nga lokalet ku ndodhen ashtu edhe përdorimi (pjesërisht ose tërësisht) i ndërtesave të muzeve jo për qëllime direkte të tyre, ndalohet.

Përfundim nga ky rregull mund të lejohen vetëm në bazë të një autorizimi të posaçëm të organeve qendrore nga të cilat varen muzetë.

37. Hapja dhe mbyllja e muzeve të ndryshme mund të bëhet vetëm me autorizimin e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë.

## VII. *Dispozita të fundit*

38. Autorizohet Universiteti Shtetëror i Tiranës të nxjerrë udhëzime përse i përket rregullit të mbajtjes së evidencës, regjistrimit dhe mirëmbajtjes së monumenteve të kulturës.